



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2023, ora 13:30 *online*

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 7.11.2023.
2. Seancë dëgjimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”.

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Antoneta Dhima, Bardhyl Kollçaku, Toni Gogu, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Denis Deliu, Luan Duzha, Ilirian Pendaviñji, Bujar Çela, Desantila dhe Arkend Balla.

Mungojnë:

Agron Çela, Paulin Sterkaj, Lindita Metaliaj, Flamur Noka, Kasem Mahmutaj, Asllan Dogjani, Isuf Çelaj Ervin Salianji, Enkelejd Alibeaj, Ferdinand Xhaferraj, Monika Kryemadhi dhe Lefter Gështenja.

Të ftuar:

Ulsi Manja – ministër i Drejtësisë

Admir Abrija – drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

Gentian Opre – drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Drejtorinë e Përgjithshme e Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ina Dhaskali – përgjegjëse sektori në Sektorin e Programimit Buxhetor në Drejtorinë e Përgjithshme e Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Kuorumi i ri është gati për të filluar seancën dëgjimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për nevojat buxhetore të vitit 2024.

I ftuar nga Ministria e Drejtësisë është vetë zoti ministër i Drejtësisë, zoti Ulsi Manja. Faleminderit, zoti Manja!

Zoti Manja, më dëgjoni?

Ulsi Manja – Po, ju dëgjoj shumë mirë.

Nasip Naço – Gjithashtu, të ftuar janë zoti Admir Abrija, drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, Gentian Opre, drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, zonja Ina Dhaskali, përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Këtu ne përfundojmë edhe shqyrtimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, ku Komisioni për Sigurinë Kombëtare u fokusua në aspektin e buxhetit që trajton elementet financiare në rendin publik dhe në sigurinë e vendit. Po analizojmë me vëmendje buxhetin e parashikuar për institucionet përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe të rendit publik apo edhe për institucionet që kontribuojnë në këta 2 komponentë, siç janë Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Relatore për këtë projektligj është zonja Antoneta Dhima.

Faleminderit, zonja Dhima!

Sot ne mbyllim diskutimet në parim dhe në diskutimin nen për nen që do të bëhet në datën 7 dhjetor, përpara se të votojmë, ne do të marrim në konsideratë të gjitha kërkesat dhe propozimet tuaja për t’ia relatuar Komisionit për Ekonominë.

Të nderuar kolegë, pas fjalës së ministrit dhe të relatores, do të bëni pyetje dhe diskutime të ndryshme.

Zoti Ministër, fjala është për ju.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje të gjithëve!

I nderuar Kryetar i Komisionit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është kënaqësi për mua të jem sot në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, për të prezantuar projektbuxhetin e vitit 2024 të Ministrisë së Drejtësisë, posaçërisht për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Më lejoni në krye të herës t'ju falënderoj si Komision për të gjithë mbështetjen që i keni dhënë në vazhdimësi sistemit të burgjeve në Shqipëri, për përmirësimin e infrastrukturës dhe të kushteve për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve që ne trajtojmë aktualisht në sistemin tonë! Falënderimi im vjen si ministër i Drejtësisë, por edhe në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sot në këtë mbledhje *online* të Komisionit është edhe zoti Abrija. Falë mbështetjes që ju na keni dhënë, si në aspektin e ndryshimeve ligjore, por edhe në drejtim të buxhetit, në vitin 2023 kemi arritur të realizojmë disa nga objektivat tona kryesore në mirëmenaxhimin e këtij sistemi. Konkretisht me ndryshimet e fundit ligjore, ku ju na mbështetët sa i takon ligjit “Për Policinë e Burgjeve”, ne sot nuk jemi më në situatën e mëparshme, por nga 480 vakanca që kishim përpara ndryshimeve ligjore, sot jemi në proces e sipër për të plotësuar edhe 160 vendet e fundit vakante që kemi në këtë sistem. Për këtë, merita dhe falënderimi shkon për Komisionin e Ligjeve, më falni, për Komisionin për Sigurinë Kombëtare, por edhe për të gjithë kolegët e tjerë deputetë që na kanë mbështetur në këto ndryshime.

Do të them 2 fjalë për buxhetin afatmesëm 2024-2026 të Ministrisë së Drejtësisë.

Të nderuar kolegë,

Si buxhet afatmesëm, buxheti ynë vjen në rritje, për vitin 2024 është 14,6 miliardë, për vitin 2025 do të jetë 15,8 miliardë dhe për vitin 2026 do të jetë 16,4 miliardë. Pra, siç e shihni, buxheti ynë afatmesëm 2024-2026 vjen me tregues në rritje, çka na mundëson neve të realizojmë objektivat tanë në mirëmenaxhimin e sektorit të burgjeve. Sigurisht jemi dakord me buxhetin e vitit 2024, sepse ne e kemi votuar këtë buxhet. Unë, si ministër, e kam votuar këtë buxhet në Këshillin e Ministrave dhe patjetër jemi të kënaqur me të, por sigurisht kemi edhe disa kërkesa modeste shtesë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të cilat, nëse do të merren në konsideratë nga Komisioni për Sigurinë Kombëtare, sigurisht do të na krijonin edhe mundësinë për ta menaxhuar si duhet sistemin për vitin 2024.

Buxheti i vitit 2024 është 14,6 miliardë lekë dhe vjen me një rritje prej 1,7 miliardë lekësh ose rreth 8,7% më shumë se buxheti i vitit 2023, i cili ka qenë në vlerën 12,9 miliardë lekë. Kjo rritje buxhetore i referohet edhe aktit normativ të tetorit të vitit 2023.

Përpara se t'ju bëj me dije se ku konsiston shtesa prej 1,7 miliardë lekësh, më lejoni t'ju them, të nderuar kolegë deputetë, që realizimi i buxhetit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vitin 2023, kur ka edhe pak kohë për t'u mbyllur viti buxhetor, do të shkojë në masën 100%. Pra, për 2 vjet radhazi, edhe në vitin 2022, edhe në vitin 2023, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në zërin "Shpenzime për investime kapitale" ka arritur ta realizojë buxhetin në masën 100%. Pra, edhe për vitin 2023 parashikohet i njëjti trend realizimi.

Nga rritja prej 1,7 miliardësh e buxhetit për vitin 2024, kryesisht, 1,2 miliardë shkojnë për shpenzime korrente, që kanë të bëjnë me rritjen e pagave dhe të sigurimeve shoqërore që ka pësuar sistemi përgjatë vitit 2023, por edhe për rritjet që do të bëhen në vitin 2024. Në fillimin e vitit 2024 për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve është buxhetuar edhe rritja e pagave. Këtu dua të jem i saktë dhe drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve më konfirmon që do të fillojë zbatimin më 1 prill 2024, sepse kjo është e parashikuar tashmë në buxhetin e vitit 2024; 28,3 milionë lekë (*nuk kuptohet*); me 595 milionë lekë janë shtuar fondet për kompensimin financiar të ish-pronarëve dhe 74 milionë lekë për aparatën e Ministrisë për përkthimet. Pra, kjo është rritja buxhetore që ka të bëjë kryesisht me shpenzimet korrente.

Ndërsa, lidhur me sistemin e burgjeve, për të cilin jemi edhe sot në këtë dëgjese në Komisionin për Sigurinë, projektet kryesore të investimeve për sistemin brenda tavaneve buxhetore për vitin 2024 konsistojnë në pajisje speciale kontrolli për sigurinë në sistemin e burgjeve, pra skanera, porta metali dedektor, kamera për sigurinë 96 milionë lekë; në blerjen e automjeteve, të ambulancave, të autoburgjeve në masën 66 milionë lekë; në përmirësimin e kushteve fizike të jetesës nëpërmjet përmirësimit të përgjithshëm të infrastrukturës në IEVP-të e Peqinit, të Korçës, të Fushë-Krujës në vlerën 95,8 milionë lekë; në riparimin e sistemeve ngrohje-ftohje në IEVP-të e Elbasanit, të Beratit, të Fierit 20 milionë lekë dhe 15 milionë lekë shkojnë për studime, projektme dhe për rishikimet e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës në sistemin e burgjeve.

Këto janë shpenzime kapitale në investime brenda tavaneve buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për vitin 2024, të parashikuara në buxhetin që ne kemi marrë.

Sigurisht, mbi tavanet buxhetore ne kemi pasur disa kërkesa shtesë për të garantuar vazhdimësinë e kontratave që ka sot Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Janë disa kërkesa për shpenzime mbi tavanet buxhetore, por unë do të ndalesha vetëm te vazhdimësia e kontratës së uniformave për Policinë e Burgjeve, për të cilat tashmë ne e kemi lidhur kontratën, ka filluar edhe fabrikimi dhe janë marrë masat për 100% të uniformave të Policisë së Burgjeve. Për ta përmbyllur plotësisht kontratën në vitin 2024, ne do të donim edhe 576 milionë lekë, nëse do të jetë e mundur nga Ministria e Financave, gjithmonë me mbështetjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Nuk dua të vazhdoj me kërkesa të tjera modeste që kemi mbi tavanet buxhetore për sistemin e burgjeve, por, nëse do të na akordohej shuma prej 576 milionë lekësh, ne do ta mbyllim tërësisht kontratën e uniformave për Policinë e Burgjeve.

Në mënyrë të përmbledhur, ky ishte buxheti ynë për vitin 2024 për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe për t'u kthyer aty ku e nisa në fillim, të nderuar kolegë, falë kësaj mbështetjeje nga Komisioni, nga Parlamenti, por edhe nga Ministria e Financave dhe qeveria, ne kemi arritur që për 2 vjet radhazi, pra në vitet 2023 dhe 2024, të realizojmë disa nga objektivat tona më të rëndësishme në drejtim të menaxhimit të sistemit, që kanë të bëjnë jo vetëm me përmirësimin e kushteve fizike në IEVP-të tona, por edhe me modernizimin e flotës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Meqenëse jemi në këtë pikë, në dijeninë time Ministria e Drejtësisë i ka sjellë ftesat për të gjithë deputetët pa përjashtim të Komisionit të Ligjeve, më falni, të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, pozitë dhe opozitë. Ne do të kemi një aktivitet të rëndësishëm në datën 24 nëntor te sheshi “Nënë Tereza”, për prezantimin e flotës së re të automjeteve për sistemin penitenciar të burgjeve, falë edhe mbështetjes së qeverisë britanike, por një zë të rëndësishëm zënë edhe fondet e buxhetit të shtetit. Për herë të parë ne do të prezantojmë flotën tonë të re me rreth 70 automjete, autoburgje, autoambulanca, por edhe me mjete që përmirësojnë logjistikën tonë në drejtim të sistemit. Në datën 24 ne do të prezantojmë edhe një flotë të re të automjeteve me rreth 22 *minibus*, të cilët do të zgjidhin përfundimisht problemin e transportit të punonjësve të Policisë së Burgjeve nga vendi i punës në drejtim të banesave dhe anasjelltas. Kështu që e shfrytëzoj mundësinë që më dhatë për t’jua bërë ftesën publikisht, zoti Naço. Do të ishim shumë të nderuar, nëse të gjithë deputetët e Komisionit do të na nderonin me ardhjen e tyre në datën 24 në sheshin “Nënë Tereza”, ku prezent do të jetë edhe Kryeministri, zoti Rama.

Edhe një herë, shumë faleminderit për mundësinë, duke qenë i hapur për pyetjet!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Manja!

Unë do të doja t'ia japim fjalën relatores, zonjës Dhima, pa bërë komente, përveç një sugjerimi të vogël që kam për kolegët, që ne jemi Komisioni për Sigurinë Kombëtare dhe jo Komisioni i Ligjeve.

Zonja Dhima, fjala është për ju.

Ulsi Manja – Kërkoj ndjesë, sepse më ka ngelur si ves kjo puna e Komisionit të Ligjeve, zoti Kryetar, por do ta reflektoj edhe këtë tani! Komisionin për Sigurinë do ta fus në fjalorin tim të përditshëm, sepse me ju më lidh një pjesë e madhe dhe e konsiderueshme e realizimit të objektivave tona, si Ministri e Drejtësisë. Kërkoj ndjesë!

Nasip Naço – Jo, të falënderoj, por edhe unë kam qenë anëtar i atij Komisioni, edhe mua atje më ka ngelur mendja! Faleminderit!

Zonja Dhima, fjala është për ju.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti Kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për relatimin e projektbuxhetit të vitit 2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe njëkohësisht të prioriteteve të punës dhe të angazhimit tuaj për periudhën 2024-2026!

Personalisht, ju vlerësoj për angazhimin, përgjegjshmërinë, korrektësinë dhe rezultatet e arritura në punën tuaj, zoti Ministër, dhe njëkohësisht drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, si dhe stafet drejtuese dhe mbështetëse në të gjithë territorin, të cilët punojnë çdo ditë në IEVP-të në të gjithë vendin.

Në fakt, Ministria e Drejtësisë, në përputhje me kushtet, por edhe me ligjet e Kushtetutën, ushtron funksione dhe ka kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, me sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe civile, me sistemin e shërbimeve të lira juridike dhe profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, si dhe në fusha të tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të cilën e ka në varësi Ministria juaj, ka në mbikëqyrje **24 institucione të vuajtjes së dënimit, prej të cilave 21 janë burgje, 1 është spital burgu dhe 1 është institut** për të mitur. Detyrat kryesore të kësaj drejtorie janë menaxhimi i institucioneve kriminale, si dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzekutiv, duke i shndërruar dënimet penale në mundësi riedukimi.

Objektivat kryesore të sistemit të burgjet kanë qenë dhe mbeten mbajtja e të burgosurve dhe njëkohësisht e të paraburgosurve në kushte të përshtatshme sigurie dhe në kushte të përshtatshme strehimi; trajtimi human i të dënuarve dhe njëkohësisht i të paraburgosurve; menaxhimi i efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë së përgjithshme të burgjeve dhe të qendrave të paraburgimit.

Ju, në fjalën tuaj, përmendët disa prej synimeve dhe rezultatet që jo vetëm Ministria e Drejtësisë, por edhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë parashikuar në periudhën afatmesme 2024-2026, që kryesisht janë përmirësimi i kushteve në sistemin penitenciar dhe ulja e mbipopullimit në burgje, gjë e cila faktikisht, nëpërmjet amnistisë penale, do të bëjë të mundur të ulë numrin e personave që janë në 24 IEVP-të. Përqindja e IEVP-ve duhet të garantojë kushtet e sigurisë në lidhje me trajtimin dhe rehabilitimin e të dënuarve, e cila parashikon që të ruajë trendin 50% deri në fund të vitit 2026; të mbahen në kushte të përshtatshme rreth 5 500 të dënuar burra, 86 të dënuara gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe të trajtohen me shërbim shëndetësor 382 të dënuar, të cilët janë evidentuar që janë të sëmurë; të riintegrohen, nëpërmjet zhvillimit të programeve, për rehabilitimin në shoqëri të paraburgosurve dhe të dënuarve, në përputhje me standardet europiane, rreth 360 të dënuar burra, 2 të dënuara gra, si dhe 6 të dënuar të mitur; përqindja e të dënuarve, të cilët punësohen pasi fitojnë lirinë, duhet të ketë një trend konstant përgjatë viteve, konkretisht në 11%; të mbikëqyrë në mënyrë efektive 6 880 burra, 790 gra dhe 186 të mitur gjatë shërbimit të provës.

Në fakt, Ministria e Drejtësisë në buxhetin e parashikuar për vitin 2024 ka një rritje rreth 8,7%, krahasuar edhe me aktin normativ, i cili përfshinte edhe Ministrinë e Drejtësisë. Nga 9 programe që financohen për Ministrinë e Drejtësisë 54% zë programi për sistemin e burgjeve, shërbimi i kthimit dhe kompensimit të pronave zë 31%, ndërsa pjesa tjetër e programeve, duke përfshirë këtu edhe aparatën e Ministrisë së Drejtësisë, zënë mesatarisht 15%.

Sistemi i burgjeve ka prioritet vazhdimin e programeve dhe misionit të tij. Unë do të ndalem te pjesa e investimeve, pasi pjesa e pagave, sigurimeve dhe shpenzimeve operative janë planifikuar sipas nevojave që ka Ministria e Drejtësisë. Pagat jo vetëm në sektorin e burgjeve, por në të gjithë sektorët e administratës publike, më saktë në të gjitha institucionet, të cilat raportojnë pranë Komisionit të Sigurisë Kombëtare, do të kenë një rritje për vitin 2024.

Sa u përket investimeve, ato do të mbështeten në blerje pajisjesh speciale për kontrollin e sigurinë në sistemin e burgjeve, ku përfshihen skanerët, porta të metalta, detektorë, kamera për

sigurinë, blerje automjeteve, autoambulancë dhe autoburgje. Ministri na tha se ditën e premtë do të zhvillohet edhe një aktivitet për dorëzimin e autoambulancave dhe autoburgjeve, shpresoj që ne si anëtarë të Komisionit për Sigurinë do të jemi prezent në këtë ceremoni. Përveç blerjes së automjeteve, ka edhe përmirësim të kushteve fizike të jetesës nëpërmjet infrastrukturës, kryesisht në IEVP-të Peqin, Korçë dhe Fushë Krujë; do të ketë riparime të sistemit të ngrohjes dhe ftohjes, kryesisht në IEVP-të Elbasan, Berat dhe Fier, njëkohësisht do të ketë edhe studim projektimi.

Në fakt, ministri në fjalën e vet tha që ka edhe kërkesa shtesë. Ministri e ka miratuar buxhetin dhe ka rënë dakord që të realizojë jo vetëm aktivitetin e Ministrisë së Drejtësisë, por edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, pavarësisht se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kërkesa shtesë në drejtim të infrastrukturës, në drejtim të blerjes së autoburgjeve dhe autoambulancave, në sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, në sistemin e ngrohjes, po kështu edhe në pjesën e rritjes së nivelit të sigurisë fizike, duke rritur sistemet e sigurisë së kamerave.

Në Komisionin e Sigurisë Kombëtare është vlerësuar sigurimi i uniformave, gjë që është shumë e rëndësishme. Ndaj para disa vitesh ne kemi nënvizuar sigurimin e uniformave të stafit ushtarak, si dhe kemi akorduar fonde shtesë për të. Njëkohësisht kërkohet shtesë fondi gati 1 miliard lekë për sistemin e burgjeve për të mbuluar disa nevoja, që mendoj se janë nevoja imediate sa i përket ushqimit, bazës materiale (dyshekë, batanije çarçafë), blerje karburanti, shpenzime të energjisë elektrike, si dhe sigurim të uniformave.

Unë besoj se Komisioni i Sigurisë Kombëtare do të jetë unanim në vendimmarrje për kë të buxhet. Unë si anëtare e Komisionit të Ekonomisë bashkë me dy kolegët, që janë pjesë e Komisionit të Ekonomisë, kur të vijnë raportet e komisioneve për ndryshimet në buxhetin e vitit 2024 do të diskutojmë për këtë pikë.

Meqenëse kam fjalën, zoti kryetar, dua t'i drejtoj disa pyetje ministrit, si dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Së pari, sa është numri i personave në paraburgim që presin gjykimin dhe marrjen e dënimit për veprat që kanë kryer? Sa prej tyre e kanë kaluar afatin 3-vjeçar të gjyqimit? Nëse ka raste, cila është arsyeja që nuk është realizuar gjykimi për veprën që ata kanë kryer?

Së dyti, pritet të kryhet së shpejti amnistia penale, sa është numri i personave që do të përfitojnë nga kjo amnisti? Ajo që mua më intereson më shumë është: sa është numri i grave që do të përfitojnë nga kjo amnisti?

Së treti, a keni parashikuar ndërhyrje në përmirësimin e infrastrukturës dhe njëkohësisht të kushteve të jetesës në burgun e grave, pasi së bashku me disa kolege deputete kemi qenë disa herë në aktivitete të ndryshme dhe kemi parë nga afër situatën jo vetëm të infrastrukturës, por njëkohësisht të kushteve të jetesës ku ato vuajnë dënimin e tyre, kushtet nuk janë ato që duhen dhe nuk janë sipas standardeve që ne kërkojmë?

Së katërti, me projektbuxhetin e planifikuar për vitin 2024 për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve a realizohet misioni dhe detyrimi juaj si për mbështetjen e personelit, po ashtu edhe për plotësimin e kushteve të jetesës për të burgosurit dhe për të paraburgosurit?

Së pesti, kujdesi për shëndetin fizik dhe shëndetin mendor për të burgosurit dhe të paraburgosurit është shumë i rëndësishëm. A i keni plotësuar të gjitha IEVP-të, si dhe spitalin e burgut me personelin e nevojshëm mjekë dhe infermierë?

Së gjashti, a ka menduar Ministria e Drejtësisë për të bërë disa ndryshime ligjore lidhur me rastet kur një person, i cili ka vuajtur dënimin penal dhe pas gjykimit ose ankimimit të tij ai ka fituar pafajësinë, kush do t'i paguajë shpenzimet që ka harxhuar institucioni juaj ose më saktë qeveria shqiptare për kohën që personi ka qenë banorë i përkohshëm në IEVP?

Së fundi, në disa vende të BE-s funksionojnë burgjet e hapura, ku i dënuari, kryesisht për vepra të lehta, punon për veten e tij dhe njëkohësisht siguron të ardhura për familjen. A do të aplikohen edhe në vendin tonë burgjet e hapura?

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Dhima, për relatimin dhe pyetjet tej profesionale!

Besoj se ministri në mënyrë koncize do të përgjigjet për pyetjet që kanë të bëjnë me buxhetin, ndërsa pyetjet e tjera do t'i lëmë për një seancë tjetër, në seancën e amnistisë, duke shpresuar edhe mirëkuptimin e zonjës Dhima.

Nga relatimi i zonjës Dhima unë doja të shkëpusja pjesën e pyetjeve, që ishin tejet profesionale, por do të doja të mos të zgjatemi shumë te pyetjet që kanë të bëjnë me amnistinë, por vetëm tek ato që kanë të bëjnë me buxhetin. Besoj se kam edhe mirëkuptimin e zonjës Dhima në këtë drejtim, jo se nuk është në gjendje ministri, por na shpërqendron nga diskutimi për buxhetin për vitin 2024.

Zoti Manja, fjala për ju.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Për një pjesë të pyetjeve, që kolegja Dhima, si relatore, parashtroi në këtë mbledhje komisioni, lidhur me mbipopullimin në burgje, numrin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, sa zënë të burgosurit dhe sa të dënuarit dhe problematikat e tjera, që lidhen me menaxhimin e sistemit të burgjeve, zoti Abria mund të japë një përgjigje me lejen tuaj, si kryetar komisioni.

Dua të shtoj diçka lidhur me amnistinë: amnistia është në proces. Ministria e Drejtësisë ditën e hënë ka marrë edhe opinionet ligjore me shkrim nga organet e drejtësisë lidhur me projektin e amnistisë, që ne do të kalojmë në qeveri dhe më pas do të vijë në Kuvend.

Ajo që dua të them se amnistia penale është domosdoshmëri për të ulur mbipopullimin në sistemin e burgjeve. Në komunikatën e sotme që kam marrë si ministër i Drejtësisë nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, ne jemi me mbipopullim.

Sigurisht, nuk mund të jap detaje sa është numri i përfituesve të kësaj amnistie apo sa është numri i grave që përfitojnë, sepse numri varion në varësi edhe të ndryshimeve që mund të pësojë projekti në Kuvend, sepse deputetët kanë hapësirat e duhura legislative për të thënë fjalën e tyre të fundit, gjithmonë sa i përket hyrjes në fuqi të ligjit. Nëse drafti pëson ndryshime sa i takon hyrjes në fuqi të ligjit në Kuvend në momentin që do të votohet, sigurisht edhe numri përfituesve rritet.

E kisha të nevojshme ta shpjegoja këtë për amnistinë, por më gjerësisht për amnistinë do të shprehemi në momentin që drafti do të kalojë në Këshillin e Ministrave. Për pyetjet e tjera mund të japë përgjigje zoti Abria.

Nasip Naço – Faleminderit!

Zoti Abria.

Admir Abria - Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ju falënderoj për mbështetjen që i keni dhënë sistemit të burgjeve në ngritjen e kapaciteteve si të atyre në burime njerëzore, edhe atyre në infrastrukturë! Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, siç e tha edhe ministri, për vitin 2023 e ka realizuar 100% buxhetin e saj, por edhe këtë vit buxhetor, në ecurinë e kalendarit që kemi, jemi të bindur që do ta realizojmë 100%.

Për vitin tjetër buxheti i konsultuar me ministrin e Drejtësisë, zotin Manja, është një buxhet që i përballon nevojat e veta, por, siç thatë ju, ka disa pika sensitive të cilat lidhen drejtpërdrejt me rendimentin e punës në burgje, por, gjithashtu, dhe me shërbimin që ato kryejnë.

Në përgjigje të disa pyetjeve sensitive, që u bënë nga relatorja, zonja Dhima, ju bëj me dije që sot në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve janë akomoduar 3 136 të paraburgosur, 2 167 të dënuar dhe 456 pacientë me masës mjekësore, që janë të akomoduar në burgje, gjithashtu edhe në Institutin e Shën Kollit.

Në lidhje me burgun e grave, ju bëj me dije se infrastruktura aty është shumë dobët, ne kemi pasur relacion edhe nga Avokati i Popullit, që ka rekomanduar mbylljen e atij instituti. Kemi bërë një raport të detajuar për ministrin e Drejtësisë në lidhje me mundësinë e lëvizjes nga burgu “Ali Demi” për në Pojskë. Jemi duke parë përshtatshmërinë dhe të gjitha mundësitë që kemi për ta bërë këtë, por po presim të qartësohemi sa është numri i atyre që përfitojnë nga amnistia, që të mos lëvizim popullatën e burgjeve në formë të panevojshme.

Këto janë përgjigjet që kisha për pyetjet tuaja.

Faleminderit!

Nasip Naço - Para se të fillojmë me pyetjet nga kolegët, unë kërktoj që secili të ngrejë dorën që të shikojmë radhën.

Po, zoti Kollçaku, zonja Resulaj, zoti Duzha.

Edhe unë kam dy pyetje, zoti Ministër, për ju dhe për drejtorin.

Në materialin që unë kam këtu ju kërkoni një shtesë prej rreth 1 miliard lekësh dhe si kërkesë kryesore keni sigurimin e uniformave të stafit ushtarak prej rreth 576 milionë lekësh. Pyetja ime është: ende nuk kanë uniforma punonjësit e Policisë së Burgjeve?! Është një gjë e trashëguar prej vitesh dhe ne do të dalim në datën 24 bashkë me kolegët e tjerë dhe me Kryeministrin për autoambulancat që keni sjellë. Këta do të jenë me uniformat e reja, apo pa uniforma? Ky është një problem i mbartur prej vitesh që e kemi vënë në kërkesat shtesë. Pra, ju në 1 miliard lekë gjysmat i kërkoni vetëm për uniformat? A nuk i keni planifikuar më përpara?

Pyetja e dytë ka të bëjë me rritjen e pagave. Pagat e punonjëseve të Policisë së Burgjeve me pagat e Policisë së Shtetit a janë të të njëjtit nivel? A i kemi arritur ne shtesat që bëmë dhe që janë të të njëjtin nivel, a keni kërkuar fond për pagat? A kërkoni nga komisioni mbështetje për fondin e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve? E dyta.

E treta: a është i mjaftueshëm buxheti i planifikuar, për të cilin ka rakorduar edhe ministri në qeveri, dhe shtesat që kërkohen nga ne janë vetëm 1 miliard?

Unë kam dy kërkesa. Në njërin kërkoni për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve 890 milionë lekë, ndërsa në pjesën tjetër kërkoni edhe një shtesë tjetër prej 570 milionë lekësh. Kjo është ajo që unë konstatoj nga raporti që kam.

Unë besoj se jam në një mendje me zonjën Dhima, si relatore, sa u takon pyetjeve të mia.
Faleminderit, zoti Ministër dhe zoti Abrija!

Admir Abrija – Faleminderit!

Zoti Ministër, të përgjigjem unë?

Në lidhje me buxhetin, dy zërat që kërkohen janë dy zëra të ndryshëm, njëri është kapitulli 6 dhe tjetri kapitulli 2, pra njëri ka të bëjë me shpenzimet operative korrente, aty ku futen edhe dietat, lëvizjet, karburantet, uniformat e të gjitha me radhë, ndërsa zëri i dytë është 231, ku janë pajisjet, të cilat konsiderohen si fond investimi. Kjo ishte sa u takon zërave.

Në lidhje me planifikimin që kemi bërë për uniformën e re, ju bëj me dije se tashmë në të gjithë sistemin e burgjeve pas kontratës së depozituar nga drejtuesit e Ministrisë së Brendshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka lidhur kontratën me operatorin ekonomik, operatori ekonomik ka marrë të gjitha masat për të gjithë sistemin e burgjeve, për të gjithë IEVP-të dhe për të gjithë punonjësit me uniformë të saj dhe tashmë është në proces prodhimi për lotin e parë, për të cilin ne kemi lidhur kontratën. Me aktin normativ të miratuar nga qeveria ne kemi marrë edhe një shtesë, jemi në procesin e lidhjes së kontratës për shtesën, dhe deri më datën 21 dhjetor, për pjesën e parë, kompania fituese do të dorëzojë të gjithë produktin e porositur nga ana jonë.

Shtesa që ju do të bëni do të na ndihmojë që ne të lidhim aneksin e tretë të kontratës, që do të na japë mundësi që Policia e Burgjeve të pajiset me uniformë 100%. Kjo ishte sa i takon uniformës.

Pra, ne në datën 20 dhjetor, kërkesën që kemi bërë para 90 ditësh do ta kemi të siguruar të gjithën në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Sa i takon infrastrukturës dhe investimeve në sistemin e burgjeve dhe a janë ato para të mjaftueshme, në takimin e datës 24 ne kemi përgatitur edhe një prezantim për ju, se si duhet të jetë sistemi i burgjeve në planin zhvillimor për periudhën 2024-2030. Me ndryshimin e hartës së re

gjyqësore, numrit të gjykatave, demografisë dhe urbanizimit në vendin tonë, patjetër që ka lindur si nevojë edhe rialokimi i studiove të ekzekutimit vendimeve penale në territor.

Gjithashtu, vlen të theksohet se 50% e këtyre institucioneve janë të trashëguara që nga koha e regjimit komunist dhe janë të papërshtatshme për të plotësuar të gjitha standardet, sipas rregullave europiane të burgjeve. Me planin zhvillimor të ri do të jenë të detajuara saktë vendet dhe format se si ne duhet ta zhvillohemi në territor.

Faleminderit!

Kryetar, a isha i qartë?

(Nuk dëgjohet)

Nuk ju dëgjoj.

Nuk më punojnë kufjet.

Nasip Naço – Zoti Abrija, a më dëgjoni?

Zoti Ministër?

Admir Abrija – Ju dëgjoj, zoti kryetar.

Nasip Naço – Pyetja ime kishte të bënte me pagat. A janë të njehsuara pagat te punonjësit e policisë? A janë në nivel qendror?

Admir Abrija – Po.

Nasip Naço – Pyetja tjetër. Te kërkesat shtesë që ju kërkoni për shpenzimet operative kërkoni edhe rreth 302 milionë lekë për blerje ushqimesh për të burgosurit dhe paraburgosurit. Nuk e keni planifikuar dhe kërkoni shtesë?

Admir Abrija – Sot numri i të paraburgosurve dhe i të burgosurve është rritur, pra ka gati një diferencë prej 550 vetash nga viti i kaluar, kemi një mbingarkesë në sistem, gjë që sjell rrjedhimisht rritje të shpenzimeve operative dhe atyre korrente që lidhin me ushqimin e tyre. Pra, kemi shtesë diku te 10%.

Dua të shtoj edhe një element tjetër që është shumë i rëndësishëm dhe ju e dini, sepse e kemi relatuar herë pas here në Komisionin e Sigurisë, sa i takon numrit të të sëmurëve të shëndetit mendor që trajtohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, i cili pothuajse është dyfishuar. Për këtë kërkojmë ndihmën tuaj dhe sensibilizimin e deputetëve që, për rastin konkret, Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë përgjegjësitë e veta në raport me menaxhimin e tyre.

Sa u takon pagave të punonjësve së Policisë së Burgjeve, ju bëj me dije se pagat e Policisë së Burgjeve tashmë janë njësoj me punonjësit e Policisë së Shtetit në gradë dhe në funksion, duke

pasur në konsideratë edhe vështirësitë për orët e natës. Pra, kemi pagesa, vështirësi, pagë vështirësie për orët e natës 100% të punonjësve të Policisë së Burgjeve njësoj si me ato të Policisë së Shtetit.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Arbrija!

Po, zoti Manja, fjala për ju.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço!

Më parë kisha një problem me mikrofonin.

E para, pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve sot janë të barazuara për gradë dhe funksion me punonjësit e Policisë së Shtetit. Ajo çka shpjegova gjatë prezantimit të buxhetit ishte që për vitin 2024, edhe rritja tjetër e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve është e përfshirë në këtë buxhet dhe do të zbatohet nga data 1 prill e vitit 2024, që do të jetë rritja e radhës e pagës për punonjësit e Policisë së Burgjeve.

E dyta, sepse e dëgjova nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, mua më vjen mirë që në dhjetor do të kemi uniformat e para të reja që do t'i veshin një pjesë e punonjësve të policisë, sipas grafikut dhe kalendarit që është parashikuar, por fatkeqësisht, ditën e premte, datë 24, nuk do të jetë e mundur që një pjesë e punonjësve të policisë që do të jenë në këtë ceremonial nuk do t'i kenë uniformat e reja. Lajmi i mirë është se në dhjetor do të fillojë marrja pjesë-pjesë e uniformave të reja nga punonjësit e Policisë së Burgjeve.

Shtesa që ne kërkojmë sot, nëse do të jetë e mundur, sepse me aktin normativ ne kemi marrë një sasi parash që garantojnë vazhdimësinë e kontratës së uniformave, sepse buxheti deri sa të kalojë në Kuvend edhe pëson ndonjë ndryshim, nëse do të na i jepnit 576 milionë lekë, ne e mbulojmë 100% financimin e kontratës së uniformave, edhe nga pikëpamja e buxhetimit të kësaj kontrate me operatorin ekonomik. Me aktin normativ të tetorit ne kemi marrë 900 milionë që garanton vazhdimësinë e fabrikimit të uniformave, por në dhjetor, sipas drejtorit, sepse drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve e ka grafikun që ka nënshkruar me operatorin ekonomik, ne do të kemi edhe uniformat e para të reja, por në datën 24 dhjetor jo.

E kërkoja fjalën për t'i qartësuar çështjet që lidheshin me pagat dhe uniformat.

Shtesa që ne kërkojmë, nëse do të jetë e mundur, gjithmonë, sepse ne e kemi rakorduar buxhetin me Ministrinë e Financave, le të themi do të teprojë ndonjë lek deri në kolaudimin e buxhetit në sallën e Parlamentit, janë këto 576 milionë lekë, ne e kemi vendin se ku do t'i çojmë, pra mbyllim përfundimisht financimin e kontratës.

Meqë jemi në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, dua të ngre dy probleme që kanë të bëjnë me menaxhimin e sistemit të burgjeve. Këtu do të kërkoja mbështetjen e kryetarit të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, të deputetëve të komisionit, pse jo edhe të deputetëve të Komisionit të Ligjeve, që kanë një nënkomision për trajtimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, sepse është çështje e të drejtave të njeriut. Ne kërkojmë një zgjidhje urgjente për trajtimin e personave me masë mjekësore, të cilët ne aktualisht i kemi në Shën Koll. Me ligjin për shëndetin mendor të vitit 2012, ky kontingjent personash, që ne aktualisht kemi në IEVP-në e Shën Kollit, do të duhet të trajtohet nga ministria përkatëse, për të gjitha efektet e shërbimeve që atyre u takojnë sipas ligjit, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas ligjit, detyrohet të marrë në ruajtje vetëm perimetrin e jashtëm të këtij institucioni.

Thënë më qartë, ky kontingjent personash, që shtohet nga dita në ditë, kërkon trajtim në spital, pra as më shumë dhe as më pak në një spital psikiatrik ku trajtohen të gjithë personat e sëmurë nga shëndeti mendor. Ne e kemi shqetësim këtë problem, ndonëse kemi bërë vazhdimisht përpjekje me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale për ta adresuar këtë problematikë, sepse është një nga kërkesat e vazhdueshme dhe imediate edhe të CPT-së, që ky kontingjent personash me masë mjekësore të trajtohet si të gjithë të sëmurët e tjerë mendorë në institucionet spitalore. Sigurisht, ne kemi detyrimin të mbajmë perimetrin e jashtëm. Për këta persona gjykata ka caktuar trajtimin “masë mjekësore”, pra nuk janë persona që do të duhet të izoloohen në IEVP, prandaj ne kërkojmë ndihmën tuaj. Ne i kemi bërë të gjitha përpjekjet tona. A ka zgjidhje? Sigurisht që ka zgjidhje, sepse në Shqipëri ka disa institucione që trajtojnë të sëmurët mendorë që kanë probleme, si në Vlorë dhe në Elbasan, por do të duhet të gjejmë zgjidhjen. Kjo është urgjente, sepse na ngarkon me një barrë që ligjërisht nuk na takon, por është problem që do të duhet ta adresojmë në nivelin e një zgjidhjeje të përgjithshme. Ne e menaxhojmë sot dhe më pas nëse e heqim dhe ia kalojmë Ministrisë së Shëndetësisë, problemi është që ministria përkatëse të marrë përgjegjësinë që i ngarkon ligji, po ashtu edhe ne përgjegjësinë që na ngarkon ligji dhe të dy ministritë së bashku të bëjmë menaxhimin dhe trajtimin e kësaj kategorie njerëzish, të cilët kanë nevojë për trajtim mjekësor më tepër sesa shërbimet që ne ofrojmë në IEVP-të tona.

Problemi tjetër ka të bëjë me, gjë që e ngriti edhe kolegja Dhima, trajtimin e të dënuarave dhe të paraburgosurave gra. Jam në një mendje me drejtorin, ne do të presim të hyjë në fuqi amnistia, të dimë sa është numri i përfituesve gra nga kjo amnisti, që t’i japim një zgjidhje këtij problemi. Është propozuar Pojska, një institucion i ri, të cilin ne tashmë e kemi në fazën e aredimit

dhe të mobilimit si strukturë. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve më ka propozuar zhvendosjen e tyre në Pojskë, madje për kushtet që do të kenë atje kemi edhe një rekomandim të Avokatit të Popullit, i cili na sugjeron që të bëhet kjo zhvendosje, por hap pas hapi dhe në interesin më të mirë të trajtimit të të dënuarave dhe të paraburgosurave gra do të kemi vendimmarrjen në kohën e duhur.

Në mbyllje, ne kërkojmë ndihmën tuaj për problematikën që ngrita sa u takon personave që vuajnë nga problemet e shëndetit mendor. Është një situatë ku numri i këtyre personave, sigurisht me vendim gjykate, nuk dua të jap shifrën, rritet në mënyrë të konsiderueshme. Problemi tjetër është që edhe gjykatat, sepse ligjërisht thuhet që në krye të një viti ata i nënshtrohen një riekspertimi dhe do të duhet të ketë një vendimmarrje të gjykatës, sepse një pjesë e tyre edhe shërohen, ka vite që nuk merret në konsideratë asnjë kërkesë për rehabilitimin e kësaj kategorie. Numri në IEVP-në e Shën Kollit rritet në mënyrë të vazhdueshme, ditë për ditë, javë për javë dhe muaj për muaj. Jemi në një situatë ku po e shohim veten të pafuqishëm për ta menaxhuar këtë situatë.

Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Ministër!

Unë e kuptoj shqetësimin tuaj në lidhje me burgun e Shën Kollit, kërkesa juaj është e drejtë, por nuk besoj se këtë çështje mund ta zgjidhë Komisioni për Sigurinë Kombëtare. Në bazë të ligjit nr. 9000 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, janë sekretari i Përgjithshëm dhe Kryeministri që zgjidhin marrëdhëniet midis dy ministrive. Mua personalisht nuk ma ka kërkuar njeri dhe as dua të ndërhyj në këto marrëdhënie. Kërkesa ime ka të bëjë me buxhetin, shqetësimet që kanë punonjësit e Policisë së Burgjeve kur vjen puna te pagesa për ditët e shtuna dhe të diela, nëse bëhen, dhe se çfarë mbështetje kërkon nga ana jonë.

Siç edhe jua thashë më parë, në raport nga ana juaj janë dy kërkesa.

E para, ka të bëjë me shpenzimet operative ku kërkon rreth 1 miliard lekë.

E dyta, janë edhe disa kërkesa që kanë të bëjnë me shpenzimet që kapin shifrën rreth 890 milionë lekë. Pra, i bie që kërkon rreth 2 miliardë lekë, në mos gaboj. Për këtë po. Unë së bashku me relatorin dhe deputetët e tjerë, brenda mundësive, gjithmonë për të rritur përgjegjshmërinë dhe për t’u dhënë maksimumin, mund të bëjmë ndonjë gjë në lidhje me buxhetin.

Fjalën e ka zoti Duzha.

Më pas fjalën e kanë zonja Resulaj dhe zoti Mahmutaj.

Fjalën e ka zoti Duzha, për pyetje.

Luan Duzha – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit, zoti drejtor!

Unë kam dy pyetje.

E para, ajo që kishte të bënte me uniformat e ezauroi kryetari i komisionit, gjë, e cila është bërë gangrenë, praktikisht, puna e uniformave, por, krahas uniformave, unë kam edhe një pyetje: a është parashikuar edhe arma e shërbimit për çdo punonjës që i takon ta ketë? Do të kenë armë të reja, apo do të vazhdojnë të jenë me tipet TT-të e vjetra që kanë?

Pyetja e dytë është: në dijeninë time punonjësit e Policisë së Burgjeve dalin në punë ditën e shtunë dhe ditën e diel, por edhe natën, që nuk u paguhen as si dieta, por nuk u jepet as si ditë pushimi. A është parashikuar kjo gjë në buxhet nga ana juaj si drejtori?

Pyetja e fundit: paraburgimi i Elbasanit ka një autoambulancë, që daton që nga viti 1996, a është parashikuar të ketë një ambulancë të re për të?

Ju faleminderit!

Nasip Naço – Ju faleminderit, zoti Duzha!

Zoti Abrija, më dëgjoni?

Admir Abrija – Në lidhje me orët shtesë për punonjësit e Policisë së Burgjeve, pra për ditën e shtunë, ditën e diel dhe orët e natës, ato paguhen 100%, nuk kemi pasur mungesa për para. Kemi pasur disa mungesa në lidhje me pagat kalimtare, herën e fundit, meqenëse edhe akti normativ u shty, na janë vonuar me 45 ditë, por ato kanë kaluar tashmë në thesar, ndërsa pjesa tjetër ka qenë e zgjidhur.

Në lidhje me flotën e re, është e vërtetë se autoambulanca e Elbasanit është për relike, por janë bërë të gjitha veprimet për daljen e kapitalit nga inventari. Do të marrim 8 ambulanca të reja, ku një prej tyre është parashikuar të çohet në Elbasan.

Në lidhje me armët, kemi bërë disa takime me përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes për mundësinë e alokimit të armëve të reja për sistemin e burgjeve, e kam fjalën për armët e brezit, pasi për armët e gjata i kemi të plotësuar sipas standardeve, kemi hequr kallashin dhe kemi vënë armë të shkurtra ose armë më të gjata për vëndshërbimet në rrethimet e jashtme. Kështu që, të tria këto pika janë marrë në konsideratë në planin e shpërndarjes për logjistikën e re që do të kemi në vitin 2024.

Faleminderit!

Nasip Naço – Ju faleminderit, zoti Abrija!

Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit, zoti Duzha!

Nuk mora përgjigje për pyetjen: sa është kërkesa që keni në lidhje me buxhetin, doni 1 miliard për shpenzimet operative apo 2 miliardë?

Admir Abrija – Janë 1 miliard të dyja bashkë, edhe shpenzimet korrente, edhe investimet. Në investime kemi 50 e ca milionë të rinj, kurse në shpenzimet korrente janë 30 e ca, pra bëhet fjalë për 1 miliard.

Nasip Naço – Ju faleminderit!

Zonja Resulaj, fjala për ju, për të bërë pyetje.

Pranvera Resulaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Abrija, faleminderit!

Kisha një pyetje shumë të shkurtër: si qëndron raporti personel-mbështetës apo staf, siç e quani ju, me të burgosurit apo paraburgosurit? Si është ky raport krahasuar me standardin e kërkuar, nuk them me standardin e BE-së, sepse nuk është ndoshta detyrim, por si qëndron me një standard të kërkuar ky raport? Nga kjo pastaj mund të kuptojmë ndoshta edhe nevojat për personel apo staf, edhe për shtesë buxheti, ta lidhim gjithmonë me buxhetin, siç e dëshiron edhe kryetari, por edhe siç është e drejtë.

Faleminderit, dhe punë të mbarë nga ana ime!

Admir Abrija – Faleminderit, juve!

Për sa i takon fushës së veprimit që mbulon sot Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, pra numri i atyre që ofrojnë shërbim apo sigurim në raport me numrin e të paraburgosurve është në raport me vendet e tjera të BE-së. Pra, ne sot kemi 5 731 të paraburgosur dhe të dënuar në sistemin e burgjeve, ndërkohë kemi 4 588 punonjës në nivel sistemi.

Ne jemi në fazë studimi dhe po e projektojmë që të kalojmë nga burgjet e kohës së regjimit në burgjet e rinj dhe për këtë do të kemi mbylljen e një sërë institucionesh. Duke kaluar në burgje më të mëdha, do të kemi mundësinë që të ulim edhe numrin e punonjësve, për të rritur rentabilitetin financiar të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Sot për sot numri është i mjaftueshëm. Në qoftë se do të kemi ndonjë shtesë të mundshme në fushën e veprimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, pra në qoftë se ne, për shkaqe sigurie, do të kalojmë në marrjen e kontrollit të sigurisë

për Gjykatën e Krimeve të Rënda, Gjykatën e Apelit dhe për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, atëherë mund të kërkojmë një shtesë, por ky është një studim që ende nuk e kemi mbaruar. Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Abrija!

Faleminderit zonja Resulaj, për pyetjen tejet koncize!

Zoti Kollçaku, fjala për ju.

Bardhyl Kollçaku – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe pse isha i pari që kërkoja të bëj pyetje, por e kuptoj që kolegët kanë pasur emergjenca dhe dashamirësia e kryetarit në këto raste funksionon!

Unë e dëgjova me vëmendje ministrin dhe relatoren, pa dyshim, edhe drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve.

Në radhë të parë, dua të komplimentoj zotin Abrija, për realizimin e buxhetit 100% dy vjet rresht, kjo është shprehje e profesionalizmit, por edhe seriozitetit për çdo lek që alokohet! Natyrisht, ky realizim krijon mundësinë dhe hapësirën që edhe komisioni ynë, edhe Ministria e Financave, por edhe qeveria ta shohin mundësinë për ta shtuar buxhetin.

Së dyti, falënderoj ministrin e Drejtësisë, që, edhe pse ka agjendë shumë të ngjeshur, gjen kohën dhe i bashkohet kësaj dëgjese shumë të rëndësishme, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është një nga institucionet kryesore brenda Ministrisë së Drejtësisë, njëkohësisht e falënderoj edhe për ftesën që na bëri për datën 24!

Para se të bëj pyetjen, do të doja të komentoja efektin e dy ligjeve që ka kaluar Parlamenti, që kanë qenë përgjegjësi direkte e Komisionit të Sigurisë, së pari, rishikimi i ligjit “Për Policinë e Burgjeve”, ku u bënë ndryshimet e nevojshme dhe u reflektua me plotësimin e rreth 500 vakancave; së dyti, marrëveshja ndërkombëtare me Mbretërinë e Bashkuar, që u miratua me dakordësinë e opozitës, ku frytet e saj po shihen në të dyja kahet, pasi shqiptarët që vuajnë dënimin në Mbretërinë e Bashkuar do të ekstradohen në Shqipëri për të vuajtur dënimin pranë të afërmeve të tyre, por gjithashtu Mbretëria e Bashkuar do të japë asistencën e saj në sistemin penitençar edhe për Ministrinë e Drejtësisë. Kjo është një politikë e zgjuar e qeverisë shqiptare, dhe unë ndihem mirë që isha pjesë e anëtarëve të këtij komisioni kur u miratua kjo marrëveshje. Shpresoj dhe uroj që të kemi marrëveshje të tilla të suksesshme edhe me vendet e tjera, ku vuajnë dënimin shtetas shqiptarë, pasi kjo ka të bëjë me të drejtat e njeriut dhe me mundësinë që u japim bashkatdhetarëve tanë që atë pjesë të mbetur të dënimit ta vuajnë pranë të afërmeve të tyre në Shqipëri!

U diskutua gjatë për rritjen e rrogave, ekuivalentimin e tyre me ato të strukturave të tjera të sigurisë në vend, dhe më vjen mirë që ka një vëmendje të shtuar për policët e burgjeve. Buxheti ka një rritje, siç u tha, prej 8,7%, por edhe mundet që gjatë rialokimit të buxhetit të bëhen ndryshime gjatë vitit 2024, gjithashtu mund të kemi shtesa dhe ndryshime edhe para se të miratohet si buxhet.

Pyetja ime për ministrin është: lidhur me marrëveshjen që kemi me Mbretërinë e Bashkuar sa parashikohet të jetë numri i të burgosurve që mund të ekstradohen në Shqipëri për të vuajtur dënimin për vitin 2024? A mund të kemi një shifër edhe nga vendet e tjera, me të cilat kemi marrëveshje të ngjashme, që do t'i shtohen sistemit tonë?

Amnistia që do të diskutojmë në fund të vitit mund t'u japë frymëmarrje 24 burgjeve që kemi në Shqipëri, sepse sot që flasim jemi në kapacitete maksimale. Pra, sa do të jetë numri i të dënuarve që do të ekstradohen nga shtetet me të cilat kemi marrëveshje në vitin 2024, në mënyrë që edhe amnistia të ketë njëfarë balancimi dhe të japë frymëmarrje në burgjet tona?

Pyetja e dytë është: në datën 24 do të vijë një pjesë e ndihmave që do të japë Mbretëria e Bashkuar për flotën e automjeteve. Po investimet e huaja nga vendet e tjera mike a janë përfshirë në buxhetin prej 5-miliardësh, apo janë zë më vete? Faleminderit!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Kollçaku, për konkluzionet që bëtë!

Unë kam ngulur këmbë, këtë ua kërkoj edhe kolegëve të tjerë deputetë, te kërkesat që ka Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve apo edhe vetë ministri Manja. Shqetësim është pjesa e uniformave. Pra, në qoftë se është alokuar fondi për një pjesë të tyre, ngelet edhe një pjesë tjetër që këta e kërkojnë. A jeni dakord, të nderuar kolegë, që ta mbështesim Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, që të gjithë punonjësit të kenë të njëjtën uniformë? Pastaj, po u morëm me Kinën, me Anglinë dhe me vendet e tjera, dalim jashtë objektit që na kërkohet në këtë projektbuxhet.

Unë ju falënderoj për ndihmën që jepni, por do të doja që të përqendrohemi te kërkesat që ka Ministria e Drejtësisë apo Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kërkesat shtesë që kanë, sepse pjesën tjetër e kanë marrë. A jeni dakord dhe a mund t'i mbështesim si komision, që të gjithë punonjësit e burgjeve t'i kenë uniformat njësoj?

Më mirëkuptoni, zoti Kollçaku, nuk ju lashë të fundit për nga rëndësia, por shqetësimet ishin edhe të kolegëve të tjerë, por duke ditur që do të bënit konkluzione, ju krijova mundësinë t'i bënit në fund.

Zoti Manja, keni mbështetjen time dhe të kolegëve për plotësimin e nevojave tuaja shtesë për buxhetin e vitit 2024.

Ulsi Manja - Unë i mirëpres!

Gjatë fjalës suaj përmendët 2-3 herë se sa kemi kërkuar në vlerë mbi tavanet buxhetore, ato janë 1,3 miliardë në total, por, si ministër i Drejtësisë do t'ju kërkoj, nëse është e mundur, të na mbështesni për 576 milionë lekë, që t'i mbyllim përfundimisht atë që ju thatë, uniformat e reja që do të kenë punonjësit e Policisë së Burgjeve. Për pjesën tjetër, sigurisht që tërhiqemi, sepse, po të ishte për ta marrë, do ta kishim marrë kur kaluam buxhetin në qeveri. Jemi në fazën e diskutimit në komisione dhe mund të ketë rialokime apo axhustime të buxhetit deri në momentin e miratimit. Ne do ta konsideronim zgjidhje, që ta mbyllim njëherë e mirë këtë problem dhe këtë kontratë, nëse do të na mbështesni me 576 milionë lekë për uniformat. Këtë kemi si kërkesë tonën të fundit.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Ministër!

Mund t'u përgjigjeni edhe pyetjeve të zotit Kollçaku, në vlerësimin tuaj?

Ulsi Manja – Lidhur me marrëveshjen me Britaninë e Madhe, sigurisht që këtë proces e ndjekim ne, si Ministri e Drejtësisë, sepse ne jemi organi kompetent për transferimet. Në këtë zinxhir dhe në këtë proces është e përfshirë edhe gjykata, që do të bëjë njohjen dhe konvertimin e dënimeve. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje ka filluar dhe në Prokurorinë e Përgjithshme kemi dërguar 48 kërkesa për t'ia përcjellë gjykatës. Do të vijojë trajtimi i këtyre kërkesave në gjykatë, pastaj fillon faza tjetër e komunikimit me palën britanike. Deri tani persona të dënuar dhe të transferuar, për shkak të marrëveshjes, nga Britania fizikisht janë vetëm 2, pjesa tjetër janë në proces.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Ministër!

Ka pyetje të tjera nga kolegët deputetë? Nëse jo, kalojmë në diskutime.

Besoj se nëpërmjet pyetjeve një pjesë e mirë e kolegëve kaluan te konkluzionet dhe diskutimet.

Zoti Ministër, ju falënderoj dhe, njëkohësisht, mbështes pa asnjë rezervë institucionin që drejtoni!

Falënderoj dhe mbështes Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve pa asnjë lloj rezerve për shkak të rëndësisë që ka institucioni që drejton!

Dua t'ju them edhe kolegëve që në burgjet shqiptare vetëm për veprën penale të vrasjes vuajnë dënim mbi 1300 persona, në mos gaboj, nga këta mbi 250 janë dënuar me burgim të

përrjetshëm, çka tregon rëndësinë që ka ky institucion, që këta persona ta vuajnë dënimin e dhënë nga gjykata, por brenda këtyre kushteve të trajtohen njerëzisht, sipas të gjitha konventave dhe të gjitha parametrave të tjerë europianë.

Unë besoj se Komisioni për Sigurinë Kombëtare, relatorja, unë, si kryetar, por edhe të gjithë deputetët do t'ju mbështesim maksimalisht për kërkesat tuaja për shkak të rëndësisë që ka institucioni juaj, për shkak të punës dhe imazhit, gjithmonë në rritje, që kanë Ministria e Drejtësisë, por edhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Besoj se në datën 7 dhjetor, kur të kalojmë projektbuxheti nen për nen, ne do t'ju mbështesim me votë, me argumente, qoftë edhe me amendamente për të plotësuar kërkesat tuaja tejet të domosdoshme, që punonjësit e Policisë së Burgjeve të trajtohen njësoj në parametra, në pagesë dhe në imazh si punonjësit e Policisë e Shtetit, që të mos ketë diferencime, siç ka qenë gjatë këtyre viteve.

Faleminderit, zoti Ministër!

Faleminderit, zoti Abrija!

Ju vlerësoj maksimalisht për punën që bëni!

Faleminderit, kolegë!

Seanca mbyllet. Besoj se kemi dhënë provat që do të votojmë në parim në datat 20 dhe 21 dhe nen për nen në datën 7 dhjetor.

MBYLLET MBLEDHJA